

**Platformë për ushtrimin e funksionit të Kryetarit të Seksionit të Shkencave Natyrore
dhe Teknike për mbarëvajtjen e Akademisë së Shkencave**

Akademia e Shkencave është në fazën e finalizimit të reformimit të saj, kur i duhet të kontribuojë në plotësimin e legjislacionit të ri dhe të përmirësojë veprimtarinë në përputhje me të. Në këtë fazë kemi edhe rinovimin e vonuar të organeve drejtuese, cka e ben situatën edhe më sfiduese.

Në një kontekst të tillë roli i mandatit të Kryetarit të Seksionit të Shkencave Natyrore dhe Teknike duhet ti përshtatet kushteve dhe detyrave të reja. Mund të dallojmë disa përbërës të këtij roli.

Se pari, nxitja e bashkëveprimit dhe kontributit midis anëtarëve të Seksionit si i tillë dhe në përbërje të Asamblesë, duke synuar forcimin e komunikimit nëpërmjet mjeteve aktive të telekomunikacionit.

Së dyti, vazhdimësia me cilësi e veprimtarive tipike të Akademisë, si botimet, etj. duke synuar rritjen e përfshirjes dhe bashkëpunimit me institucionet e tjera shkencore dhe komunitetin brënda dhe jashtë vendit.

Se treti, kontributi në plotësimin e legjislacionit të ri për shkencën dhe në vecanti për Akademinë, plotësim që do të hapë rrugën për pranimin e anëtarëve të rinj dhe normalizimin e përbërjes të Asamblesë.

Së katërti, ndjekja e projekteve në vazhdim dhe synimi për tu përfshirë në projekte të tjerë sipas vecorive të profilit të Akademisë, me angazhimin sa më të madh të anëtarëve të Seksionit por dhe me bashkëpunim me specialistë nga fushat e tjera në kuadrin e programeve ndërdegësore.

Nuk nguroj të theksoj se drejtuesit aktualë të Akademisë, në vecanti të Seksionit të Shkencave Natyrore dhe Teknike, kanë punuar në po këto drejtime dhe duhet ti falenderoj për kontributin e dhënë në drejtimin e Akademisë. Në formulimin e kësaj platforme shprehet dëshira për të vazhduar me përvojën më të mirë të deritanishme dhe për të sjellë dicka të re që mund të forcojnë rolin e Akademisë së Shkencave.

Tirane, 10 maj 2019

Akademik Neki Frasheri

